



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

**Kryesues i Këshillit Drejtues**  
Prof. dr. Ali Topalli

Nr. Prot. 836 Dt 22.04.2021

Bazuar në vendimin e qeverisë nr. 01/07, datë 18.04.2021, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, si dhe rekomandimeve për vendvotimet gjatë zgjedhjeve nga Manuali për parandalimin dhe luftimin e Covid-19, si dhe propozimin e Organizatave Studentore, të dorëzuar përmes KQZ-së, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 21.4.2021, mori:

**VENDIM**

Për vazhdimin e procesit zgjedhor të studentëve

1. Ndryshohet data e mbajtjes së Zgjedhjeve studentore të cilat do të mbahen në formë fizike, më 27.04.2021.
2. Obligohet Komisioni Qendror Zgjedhor që të vazhdojë punën me aktivitetet e mbetura nga Plani Dinamik, si dhe të bëjë të gjitha përgatitjet e duhura logjistike që zgjedhjet studentore të organizohen në pajtim me vendimin e qeverisë nr. 01/07, dt. 18.04.2021 dhe Manualin për parandalimin dhe luftimin e Covid-19.
3. Nëse ky vendim bie ndesh me Udhëzuesin e MSH, sipas pikës 42.3 të vendimit të qeverisë nr. 01/07, dt. 18.04.2021, atëherë vendimi shfuqizohet.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues i UIBM, më 28.3.2021, ka shpallur zgjedhjet studentore, të cilat është dashur të mbahen më 12.04.2021. Bazuar në vendimin e qeverisë nr. 01/05, datë 05.04.2021, KD në mbledhjen e mbajtur më 7.4.2021, mori vendim për shtyrje të zgjedhjeve deri në një vendim tjetër të qeverisë, sipas të cilit do të mund të lejoheshin aktivitetet, të cilat mund të zhvillohen në formë fizike, duke respektuar masat anti-Covid.

Marrë parasysh, se UIBM ka të gjitha kapacitetet infrastrukturore dhe logjistike për zbatimin me përpikmëri të rekomandimeve për vendvotimet gjatë zgjedhjeve nga Manuali për parandalimin dhe luftimin e Covid-19, si dhe kërkesën unanime të Organizatave Studentore, që zgjedhjet të mbahen në formë fizike dhe në datën e lartëcekur, Këshilli Drejtues mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të UIBM
- KQZ
- Organizatave Studentore
- Zyra për informim me publikun

Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. dr. Ali Topalli

